



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.904/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Glllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkritazi me apelin e Ali Nimani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Ali Nimanit, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Obiliq paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas shpalljes së rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017,

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Obiliq në Vendvotimin nr.1514E/01D, 1503E/02D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin më datë 10.11.2017, Ali Nimani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Obiliq, me të cilën pretendon se me kandidatin tjetër të Lëvizjes Vetëvendosje kanë vota të barabarta sepse nga dy votues që e kanë votuar me kusht në vendvotimin 1503E/02D dhe 1514E/01D ka marr vetëm një votë dhe si rezultat i kësaj ka mbetur me vota të barabarta me kandidatin tjetër me të cilën është fitues në listën e kandidatëve për anëtar në Kuvendin Komunal në Obiliq sepse ka qenë me numrin dy të listës së kandidatëve. Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur deklaratat e votuesve që e kanë votuar me kusht.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në vendvotimet si në pjesën e II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura panelie miratoi apeline apeluesit si të bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze. Nga sa u tha më sipër e duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.904/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.